

Forum i Kulturor
BULETIN INFORMATIV
Shkurt 2015

Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor – Shpall konkurs për artistët e rinj
Shkurt 2015

Mediterranea 17

**NO
FOOD'S
LAND**

Young Artists Biennale
Milano 2015

Stacion - Qendra për Art Bashkëkohor Prishtinë shpallë konkurs të hapur, me anë të së cilës do të bëjë përzgjedhjen e artistëve të rinj nga Kosova për pjesëmarrje në Bienalen e Artistëve të Rinj të Evropës dhe Mesdheut, No food's Land – Milano after EXPO, e cila do të mbahet më 22-25 tetor 2015, në Milano, Itali.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,116>

Artpolis Center – Audicion për Aktore dhe Dramaturge
Shkurt 2015



Qendra për zhvillim të Arteve – Artpolis Center shpall audicion për:

- 2 Aktore (studente në vitin e fundit të studimeve dhe profesioniste – mosha e pa caktuar)
- 1 Dramaturge (studente në vitin e fundit të studimeve dhe profesioniste)

Artpolis do të realizojë një shfaqje me aktore profesioniste dhe gra nga strehimoret e Kosovës. Shfaqja do të trajtojë dhunën dhe abuzimin e grave në Kosovë , ku aktoret do të bëhen pjesë e krijimit të shfaqjes së bashku me Regjisoren Zana Hoxha Krasniqi dhe dramaturgen.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,119>

**Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor – Ekspozitë personale e artistit Agim Balaj
Shkurt 2015**



Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor Prishtinë prezenton ekspozitën “But what distinguishes the worst bees from the best of architects is this, that the bee raises his structure in imagination before she erects it in reality”. Kjo ekspozitë është ekspozitë e parë personale të artistit Agim Balajt e cila është kuruar nga Albert Heta.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,120>

DAM Festival – Bëhet prezentimi i Koncertit të parë të DAM Fest X
Shkurt 2015



DAM Fest bëri publike datat e edicionit të tij të X, i cili do të mbahet me 28 Mars deri më 5 Prill 2015, në Prishtinë, Kosovë.

Hapjen e këtij edicioni do ta bëjë Koncerti i violonçelistit Bledar Zajmi në shoqërim të pianistes Etrita Ibrahimimi nga Shqipëria, i cili i paraprin përvjetorit të X të Festivalit.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,121>

**Dokufest – Thirrje për aplikim në edicionin e tretë të Shkollës së Filmit Dokumentar
Shkurt 2015**

**DOKU
FEST** **SHKOLLA
E FILMIT DOKUMENTAR**



Dëshironi të bëni film?

DokuFest i fton të gjithë nxënësit që të aplikojnë për kampin pranveror ku do të aftësoheni për ta xhiruar filmin tuaj dhe ta shfaqni atë në edicionin e ardhshëm të festivalit DokuFest.

Kampi pranveror mbahet nga 19-22 Mars 2015 në Prizren.

Për të aplikuar:

Na tregoni pse dëshironi të jeni pjesë e shkollës së filmit dokumentar dhe për cilën temë dëshironi të bëni film?
A keni qenë pjesë e programit të ngjajshëm për të rinjtë? Nëse po, na tregoni ku dhe kur?
Si keni kuptuar për këtë punëtori?
Bashkë me aplikimin tuaj na dërgoni:
Emrin dhe Mbiemrin
Datën dhe vendin e lindjes
Adresën
Qytetin
Shkollën dhe klasën
Numrin e telefonit
E-mail adresën

Dërgo aplikacionin deri më 15 Mars 2015
në apliko@dbkufest.com



Dokufest - Shkolla dhe Filmi Dokumentar, fton të gjithë nxënësit që të aplikojnë për kampin pranveror ku do të aftësohen për ta xhiruar filmin e tyre dhe ta shfaqin atë në edicionin e ardhshëm të festivalit DokuFest. Nga 24 Shkurti, nxënësit e shkollave të mesme do të kenë rastin të aplikojnë për edicionin e tretë të Shkollës së Filmit Dokumentar.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,122>